



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.03.2019, ora 15:30

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.02.2019
2. Seancë dëgjimore me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Gent Cakaj, lidhur me raportimin e vitit 2018 për ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.103/2016 “Për Akuakulturën””
4. Çështje të tjera (*Ndryshimi i kalendarit të punës së komisionit lidhur me vizitat bilaterale – shtesë për të vizituar edhe Gjermaninë*)

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Rudina Hajdari, Klodiana Spahiu,.

Mungojnë:

Musa Ulqini dhe Sadri Abazi

Të ftuar:

Gent Cakaj – Ministër në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme

Destid Koreshi – Drejtor Kabineti i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Altin Fuga – Përfaqësues i Drejtorisë së Traktateve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Klodiana Beshku – Këshilltare në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Palluqi – Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Muharrem Jazaj – Kryetar i Shoqatës së Akuakulturës

Vasil Jovani – Anëtar i Shoqatës së Akuakulturës

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European.

Në rend dite, sikurse ju është dërguar edhe me email, kemi: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 25.02.2019, seancë dëgjimore me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Cakaj, lidhur me raportimin e vitit 2018 për ecurinë e procesit të integritetit european dhe sfidat për vitin 2019, shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën””, si dhe çështje të tjera.

Biem dakord me rendin e ditës?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Zoti Cakaj, ju falënderoj për mundësinë dhe për përgjigjen në kohë ndaj kërkesës së të gjithë anëtarëve të këtij komisioni në lidhje me raportimin për ecurinë e procesit të integritetit gjatë vitit 2018. Sigurisht, çfarë është më e rëndësishme për ne, edhe si anëtarë të komisionit dhe të gjithë kolegët deputetë, është të ndajmë së bashku sfidat për vitin 2019, kryesisht ato deri në qershorin e këtij viti, për të ndarë, nga njëra anë, edhe rolet dhe për të kuptuar të gjithë kalendarin, duke pasur parasysh edhe dy organe tejet të rëndësishme, siç janë: Këshilli Kombëtar i Integritetit European, me të cilin zhvilluat një takim para një jave (është organ këshillimor, por shumë i rëndësishëm), dhe Komisioni për Integrimin European, i cili është komisioni parlamentar që bën edhe monitorimin e të gjithë ecurisë dhe realizimit të kalendarit që ju na keni sjellë në Kuvend!

Pa humbur kohë, po jua lë fjalën juve, për të vijuar pastaj me pyetjet dhe diskutimet nga anëtarët e komisionit.

(Diskutime në sallë)

U lutem medieve pak qetësi!

Zoti Cakaj, fjala është për ju.

Gent Cakaj – Faleminderit shumë për ftesën e bërë dhe mundësinë që të komunikojmë hapur qoftë për arritjet e deritanishme, qoftë për sfidat në vijim, qoftë për të jetësuar aspiratën e hapjes së negociatave për anëtarësim në qershor të këtij viti!

Për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës, në të njëjtën kohë edhe për të transmetuar informacionin relevant për kontekstin e këtij takimi, po filloj me komentimin e zhvillimeve që nga vendimi i fundit i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme i datës 26.06.2018 dhe të gjitha veprimeve që janë marrë qoftë në reagim të vendimit të Këshillit, qoftë si përgatitje e institucioneve të Shqipërisë për hapjen e negociatave.

Fillimisht, vendimi i fundit i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme për Shqipërinë është i rëndësishëm për së paku tri arsye kryesore.

E para, konfirmon gjetjet e progresraportit të Komisionit European dhe konfirmon arritjet e Shqipërisë në pesë prioritetet kyçe, për më tepër vlerëson rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon dhe, po ashtu, afirmon në mënyrë skajshmërisht pozitive faktin se Shqipëria, ndonëse është shtet kandidat, vepron në përputhje absolute me parimet e politikës së jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit European. Pra, arsyeja e parë është konfirmimi i progresit, madje thuhet se duke iu përgjigjur pozitivisht progresit në Shqipëri, Këshilli hap mundësinë që negociatat të pasojnë në qershor të vitit 2019.

Vlen të theksohet se, po ashtu, ofrohet edhe mundësia e punës përgatitore me Komisionin European, gjë që i ka hapur rrugën procesit *screening*, që aktualisht Shqipëria e bën së bashku me Maqedoninë e Veriut.

Faktori i dytë pse ky vendim është skajshmërisht i rëndësishëm është faktori rajonal, për faktin se nuk ka pasur një shkëputje prej perspektivës europiane të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, tashmë të Maqedonisë së Veriut, dhe në procesin e integritit evoluimi ka qenë përputhshmërisht me dinamikat rajonale.

Në fund, arsyeja e tretë, përkundër faktit se tematika e zgjerimit dhe gatishmëria për procedim të mëtejshëm në procesin e negociatave në anëtarësim nuk është në nivelin më të lartë të mundshëm në anën e Bashkimit European, përsëri Shqipëria ka gëzuar mbështetjen e shumicës absolute të shteteve anëtare, gjë që tregon qëndrueshmërinë e reformave që kanë ndodhur në Shqipëri. Përgjithësisht, kjo është rëndësia e vendimit të KE-së. Menjëherë ka filluar takimi me Komisionin që në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem vetëm një minutë, sepse nuk po mundem të përqendrohem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Është mbajtur takimi i qeverisë me Komisionin, që është hapur pozicioni i koordinatorit kombëtar për procesin e *technic screen*-ingut dhe lançuar procesi i *screen*-ingut në përgjithësi.

Për t'i rënë shkurt, në reagim të vendimit të fundit të Këshillit, vlejnë 4 masa për t'u pasur parasysh nga ana e institucioneve shqiptare.

E para, ka filluar procesi i *screen*-ing dhe që nga fillimi, nga ekzaminimi i kapitujve 23 dhe 24, që kanë qenë kapitujt hapës të këtij procesi, kemi vazhduar me ekzaminimin analitik të 18 kapitujve të legjislacionit të BE-së.

Për më shumë, dhe këtu dua të jem fare transparent me ju, në këtë çast dua të lë anash mburojën diplomatike dhe dua të jem fare i hapur me ju, ne kemi bërë edhe procesin e *selfscreen*-ing në mënyrë që të procedojmë sa më shpejt që të jetë e mundur me analizën krahasuese të legjislacionit vendor me atë europian, në mënyrë që të shmangim përvojat e vendeve që aktualisht negociojnë, të cilat e kanë humbur në kohë relativisht të gjatë përgjatë procesit të *screen*-ingut bilateral. Në rastin tonë, ambicia është që procesi të marrë sa më pak kohë, sepse përgatitjet tona kanë qenë paraprake.

Aspekti i dytë, që duhet të nënvizohet përveç procesit të *screen*-ingut, është angazhimi i institucioneve shqiptare në përmbushjen e detyrimeve që derivojnë nga vendimet e Këshillit. Deri tani ka pasur një progres të konsiderueshëm në prioritetet kyçe. Nëse jeni të interesuar në fazën e pyetjeve unë mund t'ju përgjigjem.

Ne kemi dorëzuar kontributin tonë final pranë Komisionit me progresin që ka ndodhur në Shqipëri deri tani. Kjo do të thotë që ne presim një vendim pozitiv, një rekomandim pozitiv për hapjen e negociatave në qershor.

Faktori i tretë, që duhet të tërheqë vëmendjen tuaj, është po ashtu, përgatitja teknike dhe administrative e institucioneve shqiptare për të përballuar vendimet dhe dinamikat që pasojnë në rastin e hapjes eventuale të negociatave për anëtarësim. Është miratuar VKM-ja për strukturën përgjegjëse për negociim. Jemi aktualisht në fazën e kompletimit të të gjitha akteve nënligjore, që do të mundësojnë vënien në lëvizje të të gjitha institucioneve të shtetit shqiptar, nëse hapen negociatat në qershor.

Në fund, është angazhimi i dialogut politik. Me këtë rast po bëhet një fushatë intensive për të bindur veçanërisht shtetet, që kanë pasur një qëndrim pak më skeptik për sa i përket mundësisë për hapjen e negociatave, në mënyrë që ajo që është sot është aspiratë historike, të bëhet një realitet politik në qershor.

Ne jemi shpresëplotë që bazuar në progresin e ndërmarrë në Shqipëri, vendimi për hapjen e negociatave do të merret në bazë të meritave, të cilat i konfirmon Komisioni dhe jo në bazë të llogarive të tjera, të cilat ndoshta mund të vijnë në shprehje prej aktorëve të ndryshëm politikë.

Po ashtu, gjej rastin t'ju informoj që paralelisht me angazhimet që kemi pasur në fushën e procesit të anëtarësimit, ne kemi përmbushur me përpikmëri të gjitha detyrimet që vijnë edhe nga Procesi i Asocimit. Kjo nënkupton kompletimin e tetëmbëdhjetë nënkomiteteve raportuese sipas fushave të ndryshme në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Kemi ngritur Komitetin e Stabilizim-Asocimit dhe në nëntorin e vitit e kaluar Këshillin e Stabilizim Asocimit. Kjo ka sjell sinjal pozitiv për sa i përket mundësisë së hapjes së negociatave, e bazuar kjo në rolin konstruktiv dhe reformat substanciale të Shqipërisë brenda vendit, në performancën e saj në rajon dhe në politikat e saj për sa i përket akordimit me parimet e sigurisë dhe parimet e politikës së jashtme me Bashkimin Europian.

Për çdo gjë tjetër që mund të jetë në interesin tuaj unë jam në dispozicion për t'u përgjigjur.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zoti Cakaj, ju falenderoj shumë për përmbledhjen koncize duke u fokusuar më shumë te sfidat e vitit 2019! Vlen për t'u përsëritur që Bashkimi Europian do ta marrë vendimin bazuar te faktet dhe progresi i reformave. Sipas raporteve që ju na keni dorëzuar, por sigurisht duke u nisur edhe nga puna që ka bërë Kuvendi dhe kryesisht Komisioni i Integritetit Europian në lidhje me përafrimin e legjislacionit, ne kemi ecuri shumë pozitive.

Fjalën e kanë kolegët deputetë për të bërë pyetje për ministrin në detyrë, zotin Cakaj, dhe më pas vazhdojmë me diskutime.

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja nënkryetare e komisionit!

Mirëdita, zoti Cakaj!

Kam një koment dhe dy pyetje.

Së pari, do të doja që kolegët e mi të mos më ndërpresin gjatë fjalës sime, sepse mund ta etiketojnë si diçka jashtë rendit të ditës, por kjo është në kuadër të ecurisë së Shqipërisë me hapa sa më të sigurtë drejt Bashkimit European.

Zoti Cakaj, dje, në cilësinë e ministrit në detyrë, përmes një deklarate ju jeni shprehur se me qëllim që të përmbushni ambicien e qeverisë për të pasur një shërbim diplomatik dinjitoz keni vendosur të shkarkoni nga detyra rreth 20 punonjës. Ju thoni se për shkak se këta punonjës nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe profesionale për të ushtruar detyrën e diplomatit keni vendosur t'i shkarkoni.

Unë si deputete e Kuvendit të Shqipërisë deri tani nuk kam parë të publikuar asnjë vendim të arsyetuar. Këtë kërkesë unë mund ta bëj edhe në linjë zyrtare, por sipas ligjit ju keni detyrimin për transparencë, sepse ju po e kryeni këtë detyrë. Kjo për dy gjëra: E para, duke cenuar të drejtën e punës, ti dobëson cilësinë, pra, nuk i garanton punonjësit kur do t'i heqësh dhe kur do t'i vësh, cenon pavarësinë e tyre, cilësinë e punës së tyre dhe njëkohësisht shërbimin diplomatik në Shqipëri.

Pika e dytë, që dua të përmend në fjalën time, është ajo që tha ish-ministri Bushati në fjalën e tij përmbyllëse, dhe dua ta citoj, që ta dinë të gjithë se çfarë ka thënë para se të ikte: “Forcuam meritokracinë, duke përmirësuar rrënjësisht sistemin e rekrutimit dhe të karrierës në shërbimin e jashtëm mbi bazën e aftësive dhe po lë një ekip e një trupë diplomatike ambicioze, e cila punon me dinjitet për Shqipërinë”. Pra, zoti Ministër në detyrë, çfarë ndodhi me këta 20 punonjës? Nëse vërtet ju do të luftoni nepotizmin, klientelizmin apo çfarë përmendët në fjalën tuaj, a mund të na shpjegoni pse nuk na keni dhënë një arsye për këta 20 punonjës? A mund të na shpjegoni apo ndoshta është deklarata e radhës, sa për të bërë një reformë fiktive, sepse ne nuk e dimë pse janë shkarkuar këta 20 punonjës, duke pasur parasysh deklaratën e ish-ministrit të qeverisë suaj?

Shumë faleminderit!

Senida Mesi – Zonja Hajdari, kjo ishte pyetja juaj. A ka kolegë të tjerë që duan të bëjnë pyetje? Zoti Cakaj, mbani shënim, pastaj ktheni përgjigje.

Mirela Kumbaro – Zoti Cakaj, faleminderit për prezantimin dhe që jeni këtu sot me ne!

Dua të flas për një pjesë, për të cilën flitet pak, por që është një detyrim që kërkon një punë organizative, volum administrativ dhe shtrirje në kohë dhe ka të bëjë me detyrimin që kemi ne për përkthimin e të gjithë volumit të *acquis communautaire*. Është një proces shumë i rëndësishëm, në të cilin kanë kaluar të gjitha vendet e tjera para nesh, përpara se të bëheshin anëtare. Nga eksperiencia, e di që kërkohet një angazhim shumë i madh i administratës qeverisëse, madje e disa administratave dhe e disa qeverive rresht, se nuk bëhet dot as në një dhe as në dy mandate. Dua të di: ku jemi me procesin e përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhën shqipe dhe si është i organizuar?

Andrea Marto – Dua thjesht një informacion shtesë rreth qëndrimit të vendeve, të cilat ishin skeptike gjatë vitit 2018. A keni kontakte apo informacione të reja nëse vijon të jetë i njëjti qëndrim, apo ka ndryshuar?

Faleminderit!

Senida Mesi – Nëse nuk ka pyetje të tjera, zoti Cakaj vijoni me përgjigjen e pyetjes së zonjës Hajdari, pastaj me të tjerat.

Faleminderit!

Gent Cakaj – Faleminderit shumë!

Citimi i deklaratës sime nuk ishte i saktë, për shkak se thatë se unë kam vendosur të shkarkoj mbi 20 punonjës. Në deklaratën time unë kam thënë se me një pjesë të punonjësve do të shkëputen marrëdhëniet e punës dhe me një pjesë tjetër do të procedojmë sipas praktikës së transferimit, sipas nevojave reale të punës dhe jo të inercisë të së shkuarës. Kjo reformë në përgjithësi prek, në fakt, mbi 20 veta, por nuk kemi të bëjmë me 20 lirime nga puna. Kjo është sa për ta sqaruar situatën aktuale.

Së dyti, për mua është e papranueshme, veçanërisht unë pres mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, sepse ju jeni një opozitë jashtëzakonisht konstruktive dhe duhet të jeni të lumtur që po fillon reforma në shërbimin diplomatik, ajo që ka ndodhur dje. Kjo nuk është nismë e një reforme fiktive dhe as cenim i performancës, përkundrazi, është përpjekje dhe reformë substanciale për të rritur performancën. Pse?! Sepse në përfaqësitë tona diplomatike nëpër botë ka një mospërputhje midis burimeve njerëzore dhe rezultateve që ato gjenerojnë, ku një pjesë e të

emëruarve ndoshta janë tepër të vjetra, sepse kanë kaluar afatin 3-vjeçar në qëndrim dhe janë të emëruar jashtë sistemit, ose për shkak të relacioneve të ndryshme ata kanë komoditetin e mjaftueshëm të mos jenë në lartësinë e detyrës së kërkuar. Për çfarëdo lëvizje të kësaj natyre, unë dua t'ju inkurajoj fillimisht ju.

Deklarata e zotit Bushati është krejtësisht legjitime. Ministri ka bërë një punë jashtëzakonisht të vlefshme dhe falë tij e vizionit të tij Shqipëria sot qëndron në kuotën më të lartë të përfaqësimit diplomatik që ka pasur ndonjëherë. Fjala ime në deklaratë fillon pikërisht duke lavdëruar punën e zellshme të ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për 5 vjet me radhë. Nëse ju thoni se për 5 vjet me radhë ka pasur punë të zellshme dhe nuk ka hapësirë për përmirësime, kjo nuk qëndron. Nëse ju thoni se unë duhet të jem thjesht riprodhues pasiv i një politike që ka ekzistuar deri tani, as kjo nuk ekziston, sepse unë jam pjesë e trashëgimisë së asaj ministrie, ku kam shërbyer edhe si zëvendësministër. Jam i gatshëm të thelloj reformat dhe të ndërmarr veprime të guximshme, të cilat nuk janë cenim i punës, por parashetrojnë kushtet objektive që të rinjtë dhe të rejtat e këtij vendi me rezultate të shkëlqyera të bëhen pjesë e diplomacisë shqiptare.

Lidhur me pjesën tjetër të kuadrove të transferuar, meqenëse folët për transparencë, unë tashmë jam fare i hapur, po ju rikujtoj se kjo çështje nuk lidhet me rendin e ditës, por unë jam këtu për të folur edhe për çështje jashtë rendit të ditës, një pjesë e tyre duhet që përvojat e akumuluar nëpër qendra diplomatike të Shqipërisë t'i investojnë në ministri, ku aktualisht ka vakanca. Një pjesë e tyre nuk mund të qëndrojnë 7 vjet në mision diplomatike pa asnjë transferim, ndërkohë që ne kemi diplomatë në ministri që për 8 vjet nuk kanë shkuar asnjëherë jashtë Shqipërisë. Më thoni nëse ky është cenim i punës apo tendencë për të vendosur rregullin në punë? Kjo nuk do të thotë se situata në ministri ndryshon nga unë dhe çdo gjë fillon nga hiçi, por do të thotë se gjithmonë ka hapësirë për përmirësime dhe ata që do të vijnë pas meje do t'i korrigjojnë gabimet e mia dhe do të plotësojnë atë që nuk është bërë.

Në fund, për sa i përket transparencës dhe rregullit institucional në qendrat diplomatike të Shqipërisë që ju kërkoni, të cilin e konsideroni si pastrim politik dhe cenim të punës, në fakt është vetëm shenjë e lodhjes dhe e dëshpërimit politik.

Lidhur me emrat me të cilët është shkëputur marrëdhënia e punës, unë po ju them tri gjëra. Me një pjesë prej tyre marrëdhënia është shkëputur për shkaqe krejtësisht legjitime, për

shkak se ata me sjelljen e tyre kanë tejkaluar sjelljen dinjitoze të diplomatit; me një pjesë tjetër ka probleme të evidentuara me sjelljen e tyre dhe për pasojë janë marrë masa disiplinore dhe pjesa tjetër thjesht ka qëndruar në sistem gjatë dhe ka kontribuar pak për të merituar vazhdimin e mëtejshëm në shërbimin e vlefshëm diplomatik të shtetit shqiptar. Unë jam këtu, me aq mundësi dhe dije sa kam dhe me aq sa më lejon vizioni im të tentoj t'i vendos gjërat në rregullin e duhur. Mos kini frikë, se çdo emër që është shkëputur nga puna dhe çdo emër, për të cilin është urdhëruar transferimi, do të bëhet publik dhe për secilin ekziston një arsye legjitime dhe objektive pse janë marrë ato vendime. Unë pres që ju të jeni mbështetësja e parë e kësaj ndërmarrjeje, e cila mbase është e vonuar, por për mua është ende e pakët. Unë pres edhe valë të tjera përmirësimi, në rast se performanca e diplomacisë shqiptare nuk është në nivelin e duhur.

Për sa i përket përkthimit të legjislacionit, e keni materialin për praktikën, për mënyrën e organizimit të përkthimit të legjislacionit. Diçka që është e vlefshme për t'u përmendur, është bashkëpunimi me Kosovën. Në mënyrë që të mos kemi shpenzime për përkthimin e legjislacionit në gjuhën shqipe, mund ta bëjmë në mënyrë të koordinuar. Gjithsesi më e rëndësishme se sa praktika e përkthimit, është niveli i përafrimit të legjislacionit, i cili është duke vijuar sipas parashikimeve që derivojnë nga vizioni paraprak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është proces më i komplikuar, në qoftë se doni të kaloj edhe në detaje të tjera teknike. Meqenëse jemi në procesin e *screening dhe self screening*, jemi duke bërë analizat e hendeqeve midis legjislacionit të vendit dhe atij europian. Kjo mbase i ka dhënë edhe një dinamikë procesit të integritetit, për shkak se grupet institucionale të punës, të përfshira në kapituj specifikë, tashmë e kanë përgjegjësinë për të realizuar një detyrë të tillë.

Senida Mesi – A ka pyetje të tjera?

Ju lutem, a mund t'i përgjigjeni pyetjes së kolegut Marto?

Gent Cakaj – Po, kërkoj ndjesë!

Janë dy qëndrime skeptike, që i karakterizojnë vendet anëtare për sa i përket mundësisë së hapjes së negociatave për anëtarësim me Shqipërinë në qershor të vitit 2019.

Së pari, është skepticizmi në raport me procesin e zgjerimit në përgjithësi. Edhe në strategjinë e fundit të Komisionit, e publikuar në shkurt të vitit 2018, thuhet: “Bashkimi Europian fillimisht duhet të forcohet nga brenda, para se të ketë mundësi të zgjerohet nga jashtë”. Në fakt,

ky është një proces që kërkon reforma në të dyja anët: Shqipëria duhet të kryejë obligimet e veta dhe të përformojë reformat e nevojshme, por kjo gjë lidhet edhe me situatën aktuale që karakterizon Bashkimin European.

Një pjesë e shteteve anëtare ose sektorë të ndryshëm politikë të këtyre shteteve anëtare mbrojnë idenë që konsolidimi fillestar i Bashkimit European është parakusht për mundësinë e zgjerimit të Bashkimit European në Ballkanin Perëndimor e më tutje.

Së dyti, lloji i dytë i rezervave që ekzistojnë në raport me hapjen e negociatave lidhet me interpretimin e rezultateve të Shqipërisë apo të shteteve të tjera për sa u përket kushteve të nevojshme për të merituar hapjen e negociatave.

Ajo që unë mund të konfirmoj është se, për sa u përket rezervave në raport me të ardhurat në Shqipërisë. Kanë një lëvizje pozitive, nga që përgjithësisht pranuat që tashmë Shqipëria është në stadin e nevojshëm dhe ka kryer të gjitha obligimet e duhura për hapjen e negociatave në qershor të këtij viti.

Për sa i përket llojit të parë të rezervave që lidhen jo me zhvillimet në Shqipëri në veçanti apo në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, por që lidhen me vizioni tyre për BE-në është një sfidë që po merr të gjitha përpjekjet tona për të sensibilizuar vendet anëtare, ndoshta nuk po flasim për zgjerimin e BE-së por për rritjen e gatishmërisë për procesin e negocimit që do të thotë që bëhet një reformë, të gjendet një formulë e reformave paralele, që BE-ja mund ta zgjedhë rrugën e saj për konsolidim të brendshëm paralelisht duke ruajtur gatishmërinë dhe duke kultivuar mundësinë për zgjerim të jashtëm. Kjo është një prej fushave kryesore të angazhimit tonë kryesor në dialogun politik, por gjithsesi për sa u përket rezultateve të Shqipërisë në sektorë të caktuar kanë një evoluim pozitiv të disponimit politik të vendeve anëtare.

Nëse keni interesa shtesë, unë jam këtu për ju.

Senida Mesi – Faleminderit!

Po zoti Marto. Më pas e ka fjalën zonja Hajdari.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti Ministër për përgjigjen!

Unë doja të dija gjykimin tuaj për qëndrimin radikal të opozitës muajt e fundit: e ndërlikon procesin e hapjes së negociatave? Si e gjykoni ju nga kontaktet që keni me partnerët tanë strategjikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi - Zoti Ministër, mund të përgjigjeni. Më pas ka një koment zonja Hajdari.

Genti Cakaj – Absolutisht, unë dua të jem i kujdesshëm në komente për opozitën, sepse nuk dua të ndjek shembullin e tyre. Jam tërësisht i vetëdijshëm për momentin historik në të cilin gjendet Shqipëria. Një veprim i tillë nuk i kontribuon procesit të integritetit, nuk i kontribuon imazhit të Shqipërisë në Europë, nuk i kontribuon dinamikës së reformave të nevojshme që Shqipëria duhet të ndërmarrë dhe do të ndërmarrë me deputetët e rinj të opozitës. Patjetër nuk i kontribuon klimës pozitive për sa i përket hapjes së negociatave nga ana e BE-së. Për ne është e rëndësishme që pavarësisht perceptimeve që mund të përhapen si rrjedhojë e veprimeve të fundit, vazhdon kursi i reformave nga përmirësimi dhe thellimi i reformës në drejtësi dhe deri te kalimi i reformës elektorale në qershor të këtij viti.

Për mua është skajshmërisht e rëndësishme se progresi që ka ndodhur në Shqipëri, që është substancial, i pamohueshëm të mos hijezohet nga tentimi për stimulim të një krize pa arsye.

Rudina Hjadari- Faleminderit!

Kam një koment.

E para, zoti Cakaj, me shumë respekt, por ju nuk mund ta ndiqni dot modelin e opozitës, sepse nuk jeni deputet. Pra, duhet ta lini pak këtu retorikën politike. Jeni një ministër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Nuk do të doja të bënim debat!

Të dy jemi të rinj, siç e thatë edhe vetë dhe duhet të krijojmë shembullin e ri të mirëkuptimit. Jam shumë dakord me këtë gjë. Vetëm dua të shpjegoj diçka, sepse ju thatë që shkarkimi apo transferimi, tani do ta shikojmë, sepse shkarkim apo transferim nuk po e marrim vesh, ata persona që e kanë pësuar mbi shpatulla e dinë mirë se çfarë i ka ndodhur, duhet ta marrim vesh. Pra, është e drejta ime ligjore, siç e thashë, që të informohem se pse është marrë vendim nga ana juaj. Ju keni vetëm 77 ditë në atë detyrë, dhe më duket pak befasuese që arritët kaq shpejt në këtë përfundim. E para kjo.

E dyta, siç e thashë, ish-ministri i Jashtëm, Bushati, në qeverinë tuaj, pjesë e kabinetit tuaj, tha se unë po lë një grup të shërbimit diplomatik, i cili është më i afti. Ai nuk ishte ministër

për një vit, por kishte pesë vjet, gati gjashtë vjet ministër. Çfarë bëri ai djalë për aq kohë aty, në atë shërbim? A e bëri reformën administrative? A e arriti cilësinë e duhur? Pra, kemi një proces shumë të gjatë. Ne po presim që të hapen negociatat, prandaj dhe jam këtu, dua të punojmë në mënyrë konstruktive, që të hapen këto negociata, për të cilat po luftojmë kaq fort. Por nëse ju bëni mesazhe të tilla, nëse dilni me deklarata publike, se po shkarkoni njëzet vetë apo po transferoni njëzet vetë, a nuk po e cenoni kështu dinjitetin e këtyre njerëzve, a nuk po cenoni individualitetin e këtyre njerëzve, a nuk po cenoni profesionalizmin e shërbimit tuaj?

Siç e thatë edhe ju, jemi të rinj dhe nuk kemi nevojë të bëjmë të tilla deklarata publike, të cilat vërtetë e cenojnë shërbimin tonë diplomatik. Duhet të veprojmë patjetër me profesionalizëm. Kur ndërmerren veprime të tilla radikale nga një ministër, i cili është teknik dhe ka pak ditë në detyrë, kur ndërmerret një vendim kaq i madh, mendoj se nevojitet pak më shumë shpjegim. Prandaj, kjo është e drejta ime. Uroj shumë që ky vendim të mos jetë vendim represiv, të mos jetë vendim me qëllime politike dhe pa ndonjë dobishmëri për shërbimin diplomatik shqiptar.

Faleminderit edhe një herë për praninë tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Një minutë tani, sepse ka ca rregulla, të cilat duhet t'i respektojmë të gjithë. Zonja Hajdari bëri pyetjen, mori një përgjigjen, dhe nuk është e kënaqur me përgjigjen. Zonja Hajdari, sigurisht, është plotësisht në të drejtën tënde ligjore për të bërë edhe një kërkesë me shkrim, drejtuar ministrit në detyrë, zotit Cakaj, jo vetëm në lidhje me pjesën e procesit të vlerësimit, largimit apo transferimit, por edhe në lidhje me pjesën e zëvendësimit, ku do të ndiqen ato parime të transparencës, të cilat zoti Cakaj sapo i përmendi.

E rëndësishme për këtë komision, më lejoni tani të flas në emër të të gjithëve, është shërbimi që duhet të ofrohet për ata qytetarë shqiptarë që ndodhen jashtë Shqipërisë. Besoj se kjo është gjëja më e rëndësishme në këtë reformë, me qëllim që jo vetëm të rrisim cilësinë e trupit diplomatik, por të rrisim edhe shërbimin në favor të qytetarëve shqiptarë jashtë territorit.

Shkurtimisht një koment. Më pas ia japim fjalën deputetit Fate Velaj.

Gent Cakaj – E para, pikërisht në emër të kulturës, së cilës iu referuat, zonja Hajdari, për juve ministri Bushati nuk është një djalë, por është ministri me mandatin më të gjatë në

cilësinë e kryediplomatit, në historinë e pluralizmit të shtetit shqiptar. Prandaj, kam dëshirë që çdo komunikim këtu të zhvillohet mbi parametra të rregullta dhe me respektin e nevojshëm.

E dyta, duhet ta keni parasysh se midis cenimit të individualitetit, që thoni ju, dhe instalimit të një administrate dinjitoze, mbizotëron nevoja e instalimit të kësaj të dytës dhe jo dëshira për ta ruajtur me çdo kusht të parën.

Zoti Bushati ka thënë një të vërtetë të madhe, që ka lënë një administratë ambicioze pas vetes, të ndërtuar ndër vite. Kjo nuk do të thotë se nuk ka hapësirë për përmirësime dhe se ne duhet të bëhemi apologjetë të *status quo*-së.

Sfida e çdo qeverie mbase është që pas 5 vjetësh në detyrë, të rigjejë format e energjizimit dhe aktivizimit dhe jo të ruajë rezultatet që ka krijuar ndër vite. Fakti se ne duam ta sfidojmë *status quo*-në, në fakt, është edhe arsye pse jemi një qeveri aktive me vizion dhe e gatshme ta ndryshojë veten kur e kërkojnë rrethanat, dhe ky është një fakt për të cilin unë besoj se kam mirëkuptimin tuaj të plotë.

Sa i përket emrave që janë larguar, unë edhe një herë po e përsëris, një pjesë e tyre kanë tejkaluar mandatin e tyre të përshkruar të punës dhe besoj se për këtë pajtohemi se në momentin që ka tejkalime të tilla, duhet të marrim masa. Mosmarrja e masave duhet t'ju shqetësojë ju. Në momentin që keni një qeveri dhe një ministër në detyrë, a ministër formalisht, që tashmë është edhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, që nuk merr masa kur stafi në margjina të qendrave diplomatike të Shqipërisë në botë bën abuzime. Kjo është tendencë për ta luftuar kulturën e pandëshkueshmërisë, kulturën e stagnimit permanent dhe riaktivizuar diplomacinë në shkallën e nevojshme.

Po e them para kamerave dhe para publikut, unë jam i vetëdijshëm për vendimin që kam marrë, por nuk e kam marrë pse jam 77 ditë në detyrë, se më duket po harroni se unë kam qenë edhe zëvendësministër në këtë ministri nga qershori i vitit të kaluar dhe unë jam mjaftueshëm i familjarizuar me ministrinë që ta kem informacionin e nevojshëm për stafin, paçka që edhe grupet e posaçme të punës konstatojnë nevojë për lëvizje të tilla dhe ky nuk është një vendim arbitrar, por është fillimi i një reforme të nevojshme që është e vonuar dhe ka nevojë të thellohet.

Unë jam i vetëdijshëm se ka nga ata që një reformë e tillë mbase mund të mos u shkojë në favor politik, do të fillojnë cenimin e natyrave të gjithëllojshme, por unë do të jem përpara këtij procesi, sepse jam i vetëdijshëm për vendimin që kam marrë dhe jam i mirinformuar për

secilin profil që do të lirohet nga detyra ose do të transferohet në qendra të tjera diplomatike ose do të kthehet për të shërbyer në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, për të krijuar hapësirë për diplomatë të tjerë ose për një gjeneratë të re të përfaqësuesve të shkëlqyeshëm të Shqipërisë nëpër botë.

Besoj që kjo praktikë meriton mbështetjen e secilit qytetar të zakonshëm që do ta shohë Shqipërinë më mirë në përfaqësimin diplomatik dhe të secilit politikan të përgjegjshëm që do të ketë një ministri më efektive dhe më të përgjegjshme. Për çdo cenim publik të kësaj reforme unë do të jem këtu për dhënë sqarime të mëtejshme, sepse e drejta është në anën e vendimit që kam marrë.

Mbase sot mund të mos ju duket transparente dhe për shumë kohë nuk do të jetë fare transparente, sepse mua nuk më takon të dal dhe të përmend emra në publik dhe të merrem me persona të veçantë. Edhe zonja Hajdari nuk do ta bënte këtë po të ishte në detyrën time dhe unë nuk do ta kisha bërë këtë pyetje nga perspektiva e saj, por kujtdo që sot ka shqetësime rreth transparencës, unë i themi që benefitet e kësaj reforme do të jenë për të gjithë dhe rezultati i saj do të jetë për shumë shpejt i pamohueshëm.

Fatmir Velaj – Faleminderit, zoti Ministër, që gjetët kohën dhe rrugën këtu në komision, si dhe për ndriçimin që i bëtë situatës politike para hapjes së negociatave!

Nëse ka një beniamin të atij veprimi që ju ndërmorët, për shkurtimin e 20 vendeve, i pari kam qenë unë. Duke qenë në marrëdhënie me trupin diplomatik, duke qenë edhe pjesë e Komisionit për Integrimin dhe duke njohur ambasadat nga afër, e kam vënë re shqetësimin, që ju e trajtuat aq bukur dhe qartë, për këta persona, që prej vitesh qëndrojnë në trupin diplomatik, të cilët e kanë kaluar jo vetëm 3-vjeçarin, por edhe 6-vjeçarin dhe nuk e dinë as vetë se çfarë po bëjnë akoma aty dhe shpeshherë e kanë shtyrë me arsyetimin “sa të mbarojë djali shkollën, ashtu kam edhe dy probleme për të zgjidhur”.

Ju jam mirënjohës që ju filluat t’i shkurtonit menjëherë këta persona. Se çfarë ka thënë Bushati, kjo është punë e tij. Jam i bindur se edhe Bushati e ka nisur si proces këtë dhe ju e keni vazhduar punën e Bushatit.

E rëndësishme është që këta njerëz të mos hidhen në rrugë. Të gjendet një vend, që edhe mënyra dhe stadi i tyre i jetesës të mos keqësohet.

Kam një pyetje për ju: sa është numri...?

Rudina Hajdari – Nëse nuk kanë bërë shkelje.

Fatmir Velaj – Detyrimisht. Nëse kanë bërë veprime, që cenojnë statusin e tyre të diplomatit, nuk mund të kenë më vend aty, siç ishte rasti i konsullit tonë në Janinë, i cili që ditën parë m'i dogji siguresat dhe thashë: “Çfarë pune ka ky këtu?!” Ju e patë të arsyeshme dhe e hoqët menjëherë atë, sipas procedurës dhe këndvështrimit tuaj diplomatik.

Doja të dija: sa është numri i të punësuarve në Ministrinë për Europën dhe Punën e Jashtme? Sa për qind përbëjnë këta 20 vetë? Që t'u themi njerëzve se kjo është një përqindje fare e vogël. Apo është shumë e madhe dhe ne duhet të tronditemi?

Gent Cakaj – Zoti Velaj, sipas perceptimit tuaj, largimi nga shërbimi diplomatik i personit që ju përmendët, është cenim i individualitetit, apo vendosje e rregullit dhe rendit? Besoj se është kjo e dyta.

Fatmir Velaj – Përderisa thashë m'i dogji siguresat, ma bëri kokën *blackout* që në bisedën e parë dhe më ra releja...

Gent Cakaj – Në të njëjtën vazhde, janë duke ndodhur edhe ndryshimet e deklaruara dhe.

Nuk do të flas për numra, për dy arsye: e para, është krejtësisht parimore dhe politike (për të qenë korrekt me zonjën e nderuar, u përgjigja për një problem jashtë rendit të ditës, sepse jam këtu të jem llogaridhënës dhe transparent) dhe e dyta, është mbase praktike dhe pragmatike. Unë nuk ju garantoj që numri nuk do të rritet në ditët në vijim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...sepse kjo është një reformë, që nuk diktohet nga vendimet arbitrare personale, por nga performanca e diplomatëve shqiptarë nëpër botë dhe nga realizimi i detyrave që u kërkohen. Thjesht, sjellja pasive, problemet me disiplinën dhe mosqenia në lartësinë e nevojshme të përfaqësimit të Shqipërisë, tani e tutje është e patolerueshme. Përderisa kjo varet më shumë nga sjellja e diplomatëve shqiptarë në botë sesa nga interpretimi im personal, refuzoj të flas me numra, por ju siguroj se numri i këtyre të larguarve... Reforma ka shkuar mbi 20 persona, nuk po flasim për 20. 20 veta mbase është numri që qarkullon në medie, por numri do të lëvizë në varësi të nevojave të punës dhe emrat do të bëhen të ditur siç janë komunikuar. U takon personave përkatës të flasin për rastet e tyre dhe jo të flas unë në emrin e tyre.

Senida Mesi – Zoti Cakaj, ju falenderoj për përgjigjet!

Ju siguroj se keni mbështetjen e plotë të Komisionit për Integrimin European për çdo iniciativë apo reformë, e cila na afron me Europën dhe ofron shërbime më të denja dhe aty ku duhet, jo vetëm si objektiv i qeverisë shqiptare dhe Kuvendit, por si nevojë e domosdoshme e të gjithë qytetarëve shqiptarë për ta pasur Shqipërinë në ato nivele ku vendet anëtare të Bashkimit European janë.

Dua të adresoj një problematikë, që duhet ta keni në vëmendjen tuaj kryesore, për strukturat negociuese si ecuri e vendimit të Këshillit të Ministrave në dhjetor të vitit 2018. Ngritja e këtyre strukturave është një hap përpara dhe thjesht duhet të plotësohen me njerëz, por dua t'ju tërheq vëmendjen në dy elemente.

E para, Këshilli Kombëtar i Integritit European është një institucion më vete, i cili ka rol këshillues dhe është përfshirë në vendimin reciprok, ndërkohë që Komisioni i Integritit European kontrollon dhe monitoron të gjithë këtë veprimtari.

E dyta, do të donim të rishikonit detyrën e kryenegociatorit dhe kërkesat që ky apo kjo kryenegociatore (shpresoj të jetë femër) do të ketë në lidhje me opinionin që do të kërkojë nga Këshilli Kombëtar për Integrimin European. Por këto kërkesa duhet të vijnë edhe në Komisionin për Integrimin European jo vetëm për opinion, sepse roli ynë është të monitorojmë dhe kontrollojmë këtë veprimtari.

Ka ka pyetje apo diskutime të tjera?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Së pari, zoti Ministër, duhet ta dini dhe ta keni si praktikë tuajën të punës se ky është komisioni me të cilin do të keni një punë shumë intensive në javët në vijim. Dua t'ju them që jo vetëm kur ju thërret komisioni të jeni të pranishëm, por në frymën e ligjit për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritit european, duhet të jeni edhe ju vetë gjithmonë i gatshëm për t'iu drejtuar komisionit për konsultime. Ky është një proces që nuk mund ta bëjë vetëm qeveria, por një proces që duhet bërë në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë. Në fazën që jemi, edhe Kuvendi i Shqipërisë, përmes asaj që quhet diplomacia parlamentare, është munduar që me vendet, që me të drejtë një pjesë i quan “vendet skeptike”, por që janë vende me rëndësi të veçantë brenda infrastrukturës vendimmarrëse të Bashkimit European, ka vijuar punën e vet intensive. Edhe nga mbledhja e këtij komisioni qytetarët shqiptarë duhet të marrin një mesazh, që Kuvendi i Shqipërisë e vijon punën normalisht si një

institucion tejet legjitim. Kuvendi i Shqipërisë vijon punën dhe ka shpresën e madhe ashtu si 94% e shqiptarëve që do ta hedhim hapin e rëndësishëm në qershor. Unë jam shpresëplotë që, përtej asaj që quhet “fatik”, pra frikë e disa prej vendeve nga zgjerimi apo frika nga zgjedhjet europiane, ku do të prevalojë dëshira e Bashkimit European për t’u rilindur, dhe, ashtu siç thotë presidenti Makron, kjo rilindje e Bashkimit European nuk mund të ndodhë pa procesin e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.

E thashë edhe në mbledhjen e kaluar që ky komision drejtohet dhe do të vijojë të drejtohet nga opozita. Është i drejtë shqetësimi që ngre nënkryetarja e komisionit, në cilësinë e drejtueses së kësaj mbledhjeje, që të dyja këto institucione, Këshilli Kombëtar dhe komisioni i janë besuar me të drejtë opozitës. Por sapo grupet e reja parlamentare të opozitës të marrin formën dhe përmbajtjen e tyre, në krye të këtij komisioni do të jetë një përfaqësues apo përfaqësuese e nderuar e opozitës që të vijojmë punën. Sa më shumë hapësirë të ketë për opozitën në këto procese konsultimi, aq më e mirë është edhe vendimmarrja.

Do ta mbyll këtë vlerësim duke ju kërkuar që komisioni të mbahet i informuar në mënyrë të vazhdueshme me shkresa dhe informacione.

E dyta, përfitoj nga rasti, meqenëse u gjenda në këtë pjesë të diskutimit, ju lutem, mos u kompleksoni nga kritikrat apo sulmet që vijnë nga opozita, sigurisht një formë pozitive nga zonja Hajdari dhe një formë më negative nga disa ish-deputetë, për atë që po bëni në shërbimin konsullor dhe diplomatik. Mua më duken pak 20 dhe do të mirëprisja më shumë, por ky është një proces vlerësimi. Të gjithë e dimë, pavarësisht se kemi bërë shumë gjithë këto vite, përsëri jemi larg të pasurit një shërbimi konsullor që t’u shërbejë qytetarëve ashtu siç duhet. Vëllezërit dhe motrat tona, që më shumë se një e treta jeton jashtë vendit, duan të marrin shërbime shumë të mira nga shërbimi ynë konsullor, prandaj mos u kompleksoni nga kritikrat apo akuzat e padrejta që bëjnë opozita.

Zonja Hajdari e ngriti me të drejtë shqetësimin për të marrë më shumë informacion dhe unë sugjeroj që Komisioni i Jashtëm, ashtu dhe yni, të sjellin një informacion të performancës për secilin emër, sepse kjo nxit dhe rrit transparencën e vendimmarrjes dhe ky proces bazohet në performancën dhe vlerësimin e punës së tyre.

Kam qenë në këtë sallë kur me kolegët e mi ishim në opozitë dhe kanë qenë të pafundme emërimet nepotike në shërbimin diplomatik, duke filluar që nga drejtuesi më i lartë i

Kuvendit dhe deri te ministrat e qeverisë që kishin farefisën në shërbimin diplomatik. Unë nuk kam hequr dorë nga ajo që kam kërkuar kur isha në opozitë, sepse nuk bëj pjesë në atë racë politikanësh që ndryshe mendojnë kur janë në opozitë dhe ndryshe kur janë në qeverisje. Shërbimi diplomatik nuk duhet të jetë pjesë e një kaste të caktuar e shoqërisë, ku politikanët emërojnë farefisën e tyre. Shërbimi diplomatik, së pari, ashtu siç e thatë edhe ju, do të jetë i hapur për ekselentët dhe mezi pres, edhe në kuadër të “Paktit me universitetin”, të shikoj ndonjë djalë apo vajzë të re shqiptare që të mos jetë e bija apo i biri i filan politikanit apo ministrit, por të jetë e bija e një punëtori të thjeshtë, që flet shkëlqyeshëm disa gjuhë të huaja dhe ka mbaruar shkëlqyeshëm universitetin, të cilit do t’i jepet mundësia që të kontribuojë në shërbimin diplomatik dhe konsullor të vendit.

Keni bërë shumë mirë, sepse opozita atë punë ka dhe duhet të ankohet për çdo gjë. Siç referojnë mediat sot, ajo ka lobuar edhe kundër ambasadorëve të huaj që duhet të vijnë në Shqipëri, sepse mbaruan hallet e Shqipërisë dhe duhet të merret edhe me lobingun kundër ambasadorëve të vendeve të tjera, që duhet të vijnë në Shqipëri, e cila harxhon edhe para për këtë punë. Por, kur e humb toruan, nuk ka burrë nëne që të kthen më në dine, thotë populli. Prandaj vazhdoni punën që keni nisur.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Balla!

Falënderoj zotin Cakaj së bashku me stafin, por edhe anëtarët e rinj të komisionit për këtë diskutim të frytshëm për hir të hapjes së negociatave dhe zhvillimit të axhendës për integrim. Ju falënderoj!

Gent Cakaj – Faleminderit shumë!

Mbetem në dispozicion të thirrjeve tuaja në vazhdimësi

Senida Mesi – Kemi dy minuta pushim sa të kalojmë në pjesën e dytë të axhendës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.03.2019, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"" (Komision për dhënie mendimi.)

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Rudina Hajdari, Klodiana Spahiu,.

Mungojnë:

Musa Ulqini dhe Sadri Abazi

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Palluqi – përgjegjës i Sektorit të Politikave, Strategjive dhe Zhvillimit Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Muharrem Jazaj - kryetar i Shoqatës së Akuakulturës

Vasil Jovani - anëtar nga grupet e interesit

Gent CAKAJ - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Destid Koreshti – drejtor Kabineti në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Altin Fuga – nga Drejtoria e Traktateve në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Klodiana Beshku – këshilltare në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Daniela Çekani – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Senida Mesi – Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"". Kemi të pranishëm nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zëvendësministrin, zotin Roland Kristo dhe Arian Palluqin, përgjegjës i Sektorit të Politikave, Strategjive dhe Zhvillimit në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.

Pa humbur kohë, zoti Zëvendësministër, do të kalojmë në një prezantim nga ana juaj. Ku konsistojnë këto ndryshime dhe pse janë të rëndësishme? Më pas do të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet për projektligjin.

Roland Kristo – Përshëndetje!

Ndryshimet e ligjit nr. 103/2016 konsistojnë në dy gjëra kryesore, që nuk prekin thelbin, por, në një krah, sjellin një pjesë të procesit të përafrimit të Bashkimit European dhe, në krahun tjetër, mundësojnë hapjen e një procesi, i cili, me nenin 50 të ligjit aktual, ka bllokuar një proces. Ligji aktual vendosi një dispozitë bllokuese, në të cilën, pa përfunduar studimi për zonat e përcaktuara të akuakulturës, nuk do të jepet asnjë leje e re në akuakulturë. Kjo solli faktin që shumë subjekte, të cilave u mbaronte leja, deri në momentin e përgatitjes e studimit për zona të caktuara të akuakulturës do të jenë në pamundësi për të kryer aktivitetin. Ne kemi bërë këtë ndryshim që t'u japim afat deri sa të mbarojmë studimin. Kur të përfundojë studimi do të vendoset e ardhmja e tyre, ose të vazhdojnë aktivitetin atje ku janë, ose do të spostohen. Do të kemi parasysh që studimi do të jetë kompleks, pasi është përcaktuar si për në det, ashtu edhe për ujërat e brendshme. Ky është një studim, i cili do të përcaktojë zonat, si dhe do të jetë një objekt diskutimi midis Ministrisë së Bujqësisë dhe gjithë ministrive të tjera dhe në këtë mënyrë edhe zhvillimi i aktivitetit është afatgjatë dhe më i qëndrueshëm.

Ndërhyrja e dytë, që është përcaktuar në ligj, ka të bëjë me procesin e përafrimit të legjislacionit, gjë me të cilën lidhet edhe objekti i komisionit tuaj. Kjo ka të bëjë me mënyrën e organizimit dhe me krijimin e organizatave në sektorin e agrikulturës. Ne këtë gjë e kemi të mirëpërcaktuar në ligjin e peshkimit, gjë, të cilën e kemi kaluar edhe radhën që shkoj, po e njëjta pjesë është përfshirë edhe për akuakulturën, pra nuk ka asnjë lloj ndryshimi.

Nga ana tjetër duhet të kemi parasysh që organizimi ose nxitja e prodhuesve për të organizuar, qoftë nga ana e vetë subjekteve, në komision ndodhet edhe zëvendësprezidenti i shoqatës, fatkeqësisht këta ekzistojnë, por ne nuk i njohim si partnerë. Pra, me kalimin e ligjit këta do të jenë partnerët tanë për zhvillimin e sektorit.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

Fjalën do t'ia kaloj përfaqësuesve të Drejtorisë së Legjislacionit sa u takon komenteve, sugjerimeve dhe rekomandimeve nëse ata kanë.

Po, zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 103/2016 “Për Akuakulturën”” është përafuar pjesërisht me Rregulloren e BE-së nr. 1379/2013 të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 11.12.2013 “Për organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe të Akuakulturës”.

Ne si shërbim kemi analizuar përputhshmërinë e këtij projektligji me rregulloren përkatëse të BE-së dhe për një përafrim më korrekt kemi bërë disa sugjerime. Këto sugjerime për eficiencë të kohës suaj, por edhe të punës së komisionit i kemi diskutuar dhe dakordësuar me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zoti Kristo, a jeni dakord me të gjitha rekomandimet e propozuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit, të cilat anëtarët e komisionit i kanë të paraqitura edhe me *e-mail*, por i kanë edhe prezente këtu?

Roland Kristo – Jam plotësisht dakord, madje ato rekomandime janë në ndihmën tonë. Format i fillestar i ligjit tonë ka qenë në këtë mënyrë, por ndërhyrjet e ministrive më pas e kanë ndryshuar formatin, ndërsa ju e keni rikthyer përsëri në përputhje me formatin e BE-së.

Faleminderit!

Senida Mesi – A kanë kolegët ndonjë pyetje? Nuk kanë.

(Diskutime pa mikrofon)

Muharrem Jazaj – Ju falënderoj që jam pjesë e këtij komisioni!

Unë kam mjaft vite që punoj në Shoqatën e Akukualturës Shqiptare dhe merrem me këtë biznes. Shoqata ku unë jam pjesë nuk ka pasur marrëdhënie me institucionet shtetërore, sepse nuk konsiderohej e ligjshme marrëdhënia me këto institucione, sidomos me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Drejtorinë e Peshkimit. Miratimi i këtij ligji do të na bëjë më të fuqishëm si

dhe do të bëjë të mundur që ne të kemi më shumë marrëdhënie me institucionet shtetërore, duke marrë pjesë në vendimmarrje dhe problemet që ka ky biznes.

Ju falënderoj!

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Komisioni ynë nuk ka shumë kontakte me përfaqësuesit e shoqatave. Kështu që komisioni ynë, por edhe ai i Ekonomisë, duhet t'ju dëgjojmë më shumë dhe t'ju kemi pjesëmarrës në këto komisione që të adresoni problematikat dhe të mundohemi t'i japim zgjidhje.

Muharrem Jazaj - Faleminderit!

Kompania jonë punon me standardet, rregullat dhe ligjet e BE-së, që kanë primare sigurinë ushqimore për peshkun. Ne e kemi arritur këtë. Unë ju ftoj ta vizitoni këtë biznes.

Senida Mesi - Do të vijmë, sepse unë jam një nga ato që e ka vizituar biznesin tënd.

Muharrem Jazaj - Unë jam i licencuar, i kam arritur të gjitha dhe po bëj eksport në BE, eksportoje peshk, koce dhe levrek.

Senida Mesi - Unë di që ka një problem me kocen, levrekun, açugen, cironkën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

A keni ndonjë pyetje ose diskutim?

Kalojmë në miratimin në parim të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

A jeni dakord me ndryshimin e titullit? Dakord.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 3 me tri ndryshimet e propozuara? Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoni! Mirupafshim dhe gjithë të mirat!

Shumë faleminderit!

Në lidhje me pikën e katërt të rendit të ditës, kemi aprovuar kalendarin para dy ditësh dhe me kërkesën e disa kolegëve deputetë është bërë një shtesë për mundësinë e përfshirjes në axhendë, lobimin e diplomacisë së Kuvendit në takimin me kolegë deputetë të Gjermanisë. Kemi aprovuar Danimarkën dhe Francën para dy ditësh. Kisha si propozim për të shtuar në kalendar edhe Gjermaninë, pastaj, në varësi të kohës, disponibilitetit dhe mundësisë nëse realizohet apo jo, të përpiqemi që ta realizojmë.

Dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Mirupafshim!

Shumë faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Për përkthimin në frëngjisht, që ishte edhe merak im, kemi zonjën Kumbaro që mund të na e qëndisë ftesën për ambasadoren dhe pjesën e delegacionit për Francën.

(Diskutime pa mikrofon)...

MBYLLET MBLEDHJA